

## **Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së**

### **Banja Llukë, BeH**

#### **4. shtator 2010.**

Konsultimet i organizuan Shoqata e gazetarëve të BeH dhe Qendra Informativë –për ndihmë juridike nga Zvorniku. Morrën pjesë gjithsejt 42 pjesëmarrës-e dhe mysafirë. Moderator ishte Lazar Stojanov (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Për konsultimet raportuan TV BH, Gazetat e pavarura, ONASA dhe BHRT-HT 1. Para konsultimeve u mbajt debati televiziv në ATV, në të cilin morrën pjesë Arsim Gërgjaliu (Kosovë), Sllavko Kukiq, Ismet Sejfiija, Mladen Mirosavleviq, Srgjan Puhalo (BeH), Zharko Puhovski (Kroaci), Zhelimir Zhilininik dhe Lazar Stojanov.

Opinionet, qëndrimet dhe propozimet e pjesëmarrësve/eve:

Mediat, në përkrahje të Iniciativës për KOMRA-në, u ndanë në përputhje me ndikimin të cilin politikanët e kanë në ta.

Mediat, në përkrahje të kësaj Initiative, u ndanë në përputhje me ndikimin politik të cilin e kanë në ta politikanët e caktuar. (Gjenana Karup-Drushko, koordinatore e procesit konsultativ të Iniciativës për KOMRA-në, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Për disa politikanë, KOMRA nuk është e nevojshme, sepse nuk duan të ballafaqohen me të kaluarën.

Pse disa politikanë mendojnë se kjo nuk na duhet? Përgjegjja e vetme (...) është se ata njerëz nuk duan të ballafaqohen me të kaluarën, atyre u duhet nacionalizmi. (Gjenana Karup-Drushko, koordinatore e procesit konsultativ të Iniciativës për KOMRA-në, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Duhet të bëhet hulumtimi për perceptimin e Iniciativës për KOMRA-në në publik.

(...) a është bërë hulumtimi lidhur me perceptimin në media (...) tani është çështje tjetër se a është negative, pozitive, etj. Por edhe kjo është një e dhënë, sepse nëse është negative, do ta dimë se si të ndikojmë dhe ta ndryshojmë atë perceptim në kuptim pozitiv. Për këtë mendova. (Mladen Mirosavleviq, profesor, Fakulteti NUBL, Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Nuk është bërë hulumtimi mbi perceptimin për KOMRA-në, por ajo është duke u studiuar me kujdes në artikujt e shtypit.

Ne nuk kemi (...) hyrë në hulumtim, sepse kjo gjë është shumë e shtrenjtë, ndërsa akcioni është mjaft i shkurtër. Do të thotë se matjen dhe hulumtimin e perceptimit nuk e kemi bërë, megjithatë ne shumë detalisht, i kemi personat për këtë, i studiojmë artikujt në shtyp për ne, dhe për to ne e kemi analizën e përmbajtjeve të tyre, kështu që ne ato i numërojmë dhe i përcjellim, por të jem i saktë ne ato nuk i masim, unë nuk pres që për shtatë muaj, sa jemi duke punuar, ti kryejmë ato, por kemi indikacione shumë të qarta se a po na dobësohet imazhi apo prishet. (Lazar Stojanović, PR rajonal dhe drejtor i kampanjës për media i Iniciativës për KOMRA-në, Serbi, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Organizatat jo qeveritare nuk duhet ti shmangin “minat”.

Kush dëshiron që populli të jetë me të, le të mirret me politikë. Puna e atyre që janë në organizatat joqeveritare është që populli ti urrejë, dhe për mua ideja që të merrem me atë se si na shikojnë mediat, se si na shikon populli, është plotësisht e parëndësishme. Puna e organizatave joqeveritare është ti fusin temat në qendër të debatave. (Zharko Puhovski, profesor, Fakulteti Filozofik, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

(...) akoma, posaçërisht në Bosnjë e Hercegovinë duhet të shkohet (...) e jo të merremi me shmangien, por me qëllim të shkelim në çdo “minë” në të cilën hasim dhe të përjetojmë eksplodimin si shok, i cili eventualisht do të ndikojë te ndokush. (Zharko Puhovski, profesor, Fakulteti Filozofik, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Për Iniciativën për KOMRA-në ekzistojnë dy “mina” në BeH – organizatat joqeveritare të cilat janë nën ndikim politik, dhe ato të cilat për arsye të tyre e kanë lëshuar Iniciativën për KOMRA-në. Këto “mina” duhet të injorohen.

(...) kur flasim për Bosnjë e Hercegovinën, për këto mina. Një minë (...) vjen direkt nga ndikimi politik. Një pjesë e organizatave joqeveritare është direkt nën ombrellën e politikës, të cilat nuk e kanë në interes të tyre Iniciativën për KOMRA-në, ato gjithashtu finansohen direkt nga buxheti, kështu që gjenden nën të ashtuquajturën kontrollë direkte. Mina e dytë, në të cilën mund të hasë Iniciativa për KOMRA-në, në Bosnjë e Hercegovinë, është një pjesë tjetër e organizatave joqeveritare të cilat kanë qenë pjesë e nismës së KOMRA-së, dhe të cilat për arsye të tyre janë larguar nga Iniciativa. Do të thotë, se atë pjesë të historisë, vetë iniciativa për KOMRA-në, duhet ta injorojë, duke punuar pikërisht në këtë qasje për të cilën foli z.Puhovski. (Tanja Topiq, Fondacioni Fridrih Ebert, zyra në Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Pjesa më e madhe e organizatave joqeveritare, e ka lëshuar Iniciativën për arsye materiale, sepse kanë pritë që përmes këtij procesi do të përfitojnë materialisht.

(...) pse organizatat joqeveritare të cilat e kanë përkrahë procesin e KOMRA-së, nën thonjëza, atë proces e kanë “pështyrë ashpër” dhe janë distancuar nga ai. Konfirmoj me

përgjegjësi, me përjashtime të caktuara, i njoh disa nga organizatat joqeveritare të cilat e kanë bërë këtë, se këtë e kanë bërë thjesht për arsye materiale. Pra, të priturat e tyre kanë qenë, që ndoshta në këtë proces të përfitojnë materialisht. Një pjesë e madhe e organizatave joqeveritare në Bosnjë e Hercegovinë, me të vërtetë janë mësuar që përmes realizimit të projekteve dhe aktiviteteve, vetëm të përfitojnë materialisht.

Çelësi i të ardhmes, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Duhet të “shtyhet” ideja për KOMRA-në. Atë duhet ta paraqesin luftëtarët e pakompromis.

(...) e përshëndesë idenë për KOMRA-në, dhe mendoj se kjo është një ide, e cila pavarësisht nga minat dhe pengesat të cilat i cekën më parë pjesëmarrësit paraprak, duhet të jetojë dhe do të duhej të shtyhet para, pavarësisht pengesave në të cilat mund të hasë. Por megjithatë, dua të them se këtu idenë për KOMRA-në duhet ta paraqesin luftëtarët e pakompromis, njerëzit të cilët nuk janë frikësuar as gjatë luftës, e aq më pak në kohën e pas luftës. (Radmilo Golijanin, NVO Liga për mbrojtjen e pronës private dhe të drejtave të njeriut, Trebinje, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Duhet të punohet një faqe interneti me të gjeturat nga hulumtimet.

Unë propozoj, (...) që së shpejti të punohet një faqe interneti në të cilën do të vendoset plani se si do të mblidhen ato rezultate, dhe të dilet me rezultatet përfundimtare dhe të publikohen ato, si (...) se është faza e parë e hulumtimit, të publikohet në një faqe interneti solide. Ajo së pari, do të shkaktojë polemikë, nga njëra anë, por nga ana tjetër do të sjellë edhe kontribute të njerëzve. Pra, të publikohet, hapësira apo qyteti ose territori ku janë kryer hulumtimet, e kësi territore sigurisht kemi. (Zhelimir Zhilnik, regjisor, Novi Sad, Serbi, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Të vërtetat e vogla të cilat do ti paraqes KOMRA, do ti sjellin edhe të ashtuquajturat të vërtetat e mëdha.

(...) ka pasë fjalë për të vërtetat e vogla dhe ato të mëdha, të cilat janë konstruktuar si memorie kolektive të popujt e caktuar, në kontekste të caktura. Janë shkruar në bazë të fakteve të caktuara. (...) fëmijët e mi do të kenë mundësi që atë të vërtetën e madhe ta kuptojnë përmes të vërtetave të vogla, dhe kjo për mua është me rëndësi, dhe kjo është për mua ai hapi të cilin e ndërmerr KOMRA për (...) të ardhmen. (Mladena Tadej, Dokumenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Duhet të gjinden personat e zhdukur. Për krimet e kryera duhet të përgjigjen individët, e jo i tërë populli.

(...) duhet të gjinden personat e zhdukur, sepse mendoj se vërtetë kjo është diçka shumë themelore, se familjet e tyre duan të dinë të paktën ku janë eshtrat e tyre, ndërsa sa i përket krimeve duhet të dënohen individët, e jo i tërë populli. (Tanja Subotiq-Doshen, Aktivi i grave SNSD Banja Llukë/ Akademia Politike, Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

E mbështes iniciativën.

Sa i përket vetë organizatës dhe të gjithë organizatave të cilat e mbështesin këtë qëllim, unë çdo herë dhe në çdo kohë jam i gatshëm të bisedoj dhe ta mbështesë, dhe të ndihmoj në cilindo aspekt këtë akcion. (Milovan Dragojeviq, student, Fakulteti i shkencave politike, Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Më pëlqen kjo Iniciativë, dhe mendoj se ajo do të ketë pasoja me ndikim shumë të gjerë, për të cilat ne sot akoma nuk jemi të vetëdijshëm. (Srgjan Puhalo, psikolog, Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Jam i kënaqur me tërë këtë tubim, dhe e mbështesë KOMRA-në. (San Makareviq, ToPeeR, Doboj, NeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

KOMRA do të kontribuoj që gjërat e këqija të mos përsëriten.

Mendoj se me themelimin e KOMRA-së, se ky do të jetë një segment me të cilin do të vimë deri të shkaku se çka na ka ndodhë dhe të mos na ndodhë kurrë përsëri e këqija që ka qenë. (Safet Murtagiq, Çelësi i të ardhmes, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)

Duhet të ceken njerëzit të cilët u kanë ndihmuar pjesëtarëve të popujve tjerë të cilët kanë qenë në rrezik.

(...) duhet të ceken shembujt e mirë. Ka njerëz të cilët u kanë ndihmuar të tjerëve, të cilëve u është dashtë të ikin. Do të duhej të ceken dhe të emërohen ata njerëz, të përfshihen në ato të dhëna dhe të dihet për ta. Megjithatë, ai është kontribut. (Bilana Bjelakoviq, ToPeeR, Doboj, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.)